

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA Alban Zeneli

**RAPORTI NDËRMJET MEDIAVE TË REJA DHE ATYRE  
TRADICIONALE NË KOSOVË  
(GAZETA, RADIO DHE TELEVISIONI PËRBALLË  
PORTALEVE DHE RRJETEVE SOCIALE)**

PUNIM I DOKTORATËS

Prishtinë, 2020

UNIVERSITY OF PRISHTINA "HASAN PRISHTINA"  
FACULTY OF FILOLOGY

MA Alban Zeneli

**THE REPORT BETWEEN NEW AND TRADITIONAL  
MEDIA IN KOSOVO  
(NEWSPAPER, RADIO AND TELEVISION IN FRONT OF  
PORTALS AND SOCIAL NETWORKS)**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2020

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”  
FAKULTETI I FILOLOGJISË

MA Alban Zeneli

**RAPORTI NDËRMJET MEDIAVE TË REJA DHE ATYRE  
TRADICIONALE NË KOSOVË  
(GAZETA, RADIO DHE TELEVISIONI PËRBALLË  
PORTALEVE DHE RRJETEVE SOCIALE)**

PUNIM I DOKTORATËS

Mentori:  
Prof. asoc. Milazim Krasniqi PhD

Prishtinë, 2020

## REZYME

Realizimi i këtij punimi është bërë në kuadër të studimeve në programin “Shkencat e Komunikimit dhe gazetarisë” në Departamentin e Gazetarisë në Fakultetin e Filologjisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”. Ky punim me titull “Raporti ndërmjet mediave të reja dhe atyre tradicionale në Kosovë (gazeta, radio dhe televizioni përballë portaleve dhe rrjeteve sociale)”, trajton gjendjen aktuale të mediave kosovare dhe ndryshimeve që ka sjellë përdorimi i teknologjisë. Rezultatet e kërkimit përmes metodave shkencore ofrojnë gjetjen për tri sfera në mediat e Kosovës. Në sferën e parë të hulumtimit në këtë punim ofrohen gjetje për ndryshimin që ka ndodhur në përmbajtjen e lajmeve, respektimin e standardeve profesionale të raportimit në gazetari. Tutje, ky punim ofron rezultate sa i përket ndryshimit që ka ndodhur me audiencën në Kosovë, duke trajtuar rezultatet e hulumtimit përmes anketimit të responentëve në raport me përdorimin, besueshmërinë dhe përvojën me lajmet e rreme në lloje të ndryshme të medias. Në sferën e tretë, ky punim ofron gjetje në aspektin ligjor dhe vetërregullues të mediave në rastin e Kosovës. Gjetjet e këtij punimi janë unike dhe të reja në fushën e studimit të komunikimit dhe medias në Kosovë, duke ofruar kështu një studim që mund të shërbejë për komunitetin e studiuesve, komunitetin e gazetarëve dhe mediave, si dhe shoqërinë në përgjithësi.

Në punim janë përdorur metoda të testuara edhe më herët shkencore në studimin e kësaj fushe. Studimet e medias dhe komunikimit kanë qasje ndërdisiplinore, prandaj edhe metodat e përdorura për nxjerrjen e rezultateve në këtë hulumtim janë disallojëshe. Pjesa e parë e hulumtimit të lajmeve-teksteve të publikuara në lloje të ndryshme të medias është hulumtuar përmes analizimit të përmbajtjeve mediale, duke siguruar një rezultat të ri në këtë fushë të studimit. Rezultatet e gjetura përmes analizimit të përmbajtjeve në lloje të ndryshme të medias janë trajtuar me analizën krahasuese duke parë dallimin në format e raportimit dhe respektimin e standardeve profesionale të raportimit në gazetari. Korpusi i këtyre përmbajtjeve është përzgjedhur përmes mostrës sistematike të javës artificiale. Më tej, në këtë punim është përdorur metoda e anketimit të responentëve për të nxjerrë rezultate në fushën e studimit të audiencës, studime të cilat në rastin e Kosovës nuk janë realizuar më herët. Gjetjet e siguruar përmes anketimit me mostër sistematike shumëfazëshe me një numër reprezentativ të responentëve. Rezultatet e këtij hulumtimi përmes metodës krahasuese janë trajtuar në kuptim të ndryshimeve që audienca ka në raport me lloje të ndryshme të mediave; gazeta, radio, televizione dhe mediat të reja, portale dhe rrjete sociale. Në

pjesën e fundit të rastit të studimit është përdorur metoda e analizës së deksut për të nxjerrë rezultate në hulumtimin e aspektit ligjor dhe vetërregullues të mediave në Kosovë. Si pjesë e këtij studimi janë realizuar edhe intervista të cilat janë përdorur si metodë shkencore për nxjerrjen e rezultateve në aspekt të zhvillimit të mediave të reja në Kosovë. Këto metoda janë përdorur me qëllim të testimit të hipotezave në këtë studim që gjithsej janë katër. Hipoteza kryesore trajton standardet profesionale të raportimit në gazetari, në dy të tjera trajtohet raporti i audiencës me median dhe një hipotezën e tretë ndihmëse trajtohen aspektet e rregullimit ligjor dhe vetrregullimin e mediave në Kosovë.

Në kapitullin e parë të këtij studimi trajtohet korniza teorike e punimit, duke ofruar teoritë kryesore në aspekt të zhvillimit të mendimit për median. Në këtë pjesë të punimit trajtohen teoritë për komunikimin dhe median duke filluar nga studimet e propagandës, Shkollës Kritike të Frankfurtit, studimet neomarksiste, Shkollës së Torontos, studimet e semiotikës së medias, studimet kulturore, sociologjisë së profesionit - studimet funksionaliste, teorisë së mediamorfozës, teoritë për shtypin, teoritë për radion, teoritë për televizionin, teoritë për mediat e reja (interneti dhe portalet) dhe teoritë për rrjetet sociale. Këto teori trajtohen në kuptim të kundërthënive dhe pikave të tyre të përbashkëta në trajtimin e mendimit për funksionin e komunikimit, medias dhe rolin e tyre në shoqëri.

Në pjesën vijuese të këtij punimi, trajtohet konteksti historik në të cilin janë zhvilluar komunikimi dhe mediat në Kosovë. Nga burime të ndryshme historike janë trajtuar të dhënat që nga forma e parë e komunikimit me shkrim në gjuhën shqipe, si dhe qasjet teorike për arsyen e vonesës së shkrimit në këtë gjuhë. Dy teoritë kryesore të trajtuar në këtë pjesë flasin për mungesën e shkrimit në gjuhën shqipe, së pari në rrafshin e shtrirjes gjeografike të popullatës që ka folur këtë gjuhë dhe në rrafshin e dytë, atë të mungesës së institucioneve publike si arsye për mungesën e shkrimit në këtë gjuhë. Në këtë pjesë të punimit, ofrohen të dhëna në periudha të ndryshme historike që kanë ndikuar në komunikimin dhe median në gjuhën shqipe duke filluar nga gazetat e para në gjuhën shqipe, radiot, televizionet, etj. Më tej në këtë kapitull trajtohet periudha e pluraliteti medial në Kosovë, që ka filluar pas qershorit të vitit 1999 kur administrata e Kombeve të Bashkuara ka filluar punën e saj. Në këtë kuptim, punimi trajton edhe qasje mbi format e rregullimit dhe vetrregullimit të tregut media pas pluralitetit. Në një nënndarje të këtij kapitulli trajtohet aspekti i zhvillimit historik të mediave online në Kosovë. Përmes analizës së diskut dhe intervistave ofrohen të dhëna për dhjetë portalet kryesore në Kosovë të cilat ofrojnë gjetje për

pronësinë, datë e fillimit të publikimeve në internet dhe pronësinë e hapësirës së internet dhe aktivitet të ngjashme për këto dhjetë portale: Gazeta Blic, Gazeta Express, Indeksonline, Insajderi, Klan Kosova, Koha, Lajmi, Rtklive, Telegrafi, Zëri.

Në pjesën vijuese të këtij punimi ofrohen gjetjet e pjesës së parë të rastit të studimit që kanë të bëjnë me përmbajtjen mediale dhe ndryshimet në respektimin e standardeve profesionale nga ana e llojeve të ndryshme të medias në Kosovë. Në këtë kapitull trajtohen format e raportimit të tri televizione në raport me standardet profesionale ose vlerat e lajmit duke ofruar gjetje për format e raportimit të Radiotelevizionit të Kosovës, Televizionit Kohavision dhe Televizionit 21. Sipas gjetjeve në këtë pjesë të punimit raportimi i gazetave është karakterizuar me zbatim të lartë të standardeve të matura në këtë punim. Gjetjet kanë trajtuar format e raportimit dhe standardet profesionale në tri gazeta, “Koha Ditore”, “Epoka e Re” dhe “Kosova Sot”. Tutje, trajtohen gjetjet e hulumtimit për format e raportimit në radio, duke ofruar një rezultat që flet për zbatim të lartë të standardeve në këtë lloj mediumi. Në këtë kapitull trajtohen edhe gjetjet e siguruar përmes analizimit të përmbajtjeve që janë publikuar në portalet e korpusit të këtij studimi, gazetaexpress.com, telegrafi.com dhe lajmi.net. Gjetjet ofrojnë fakte të cilat tregojnë se në këto lloje të medimeve ka mungesë të theksuar të zbatimit të disa nga standardet kryesore të raportimit në gazetari siç janë; mungesa e përgjigjes në pesë pyetjet kryesore të raportimit në gazetari, balanci të informacioneve brenda lajmeve, etj. Më tej në këtë kapitull përmes komperacionit trajtohet zbatimi i këtyre standardeve të profesionale të raportimit në gazetari në mediat tradicionale, gazetës, radio dhe televizion, krahasuar me zbatimin e tyre në rastin e mediave online-portaleve. Gjetjet nga kjo pjesë e studimit rezultojnë që në mediat tradicionale me raste ka moszbatim të ndonjërit nga standardet, mirëpo në rastin e portaleve kemi përjashtim të tërësishëm të disa standardeve.

Në kapitullin e radhës, ofrohen gjetjet nga hulumtimi empirik për audiencën dhe sjelljet e saj në raport me lloje të ndryshme të mediave. Gjetjet e kësaj pjese të studimit tregojnë që përdorimi i llojeve të ndryshme të medias, besueshmërinë e publikut llojeve të ndryshme të medias dhe shpeshësinë e përdorimit të tyre është e ndryshueshme në varësi nga disa faktorë. Sipas gjetjeve që trajtohen në këtë pjesë të punimit gaztat rrezikojnë të mbesin pa publik, pasi që trendi i përdorimit të tyre si medime prej nga informohen qytetarët është në rënie. Rreth gjysma e responentëve kanë thënë që nuk kalojnë asnjë minutë kohë në leximin e gazetave brenda ditës, ndërsa një numër i madh i përgjigjeve kanë shprehur mosbesim ndaj tyre. Gjetjet e kësaj pjese

sugjerojnë që radioja ka mbetur një medium rastësor në të cilin qytetarët nuk e shohin si burim kryesor të informimit. Gjetjet e realizuara përmes metodës së anketimit tregojnë për një shikueshmëri të madhe të televizionit. Sipas rezultateve që prezantohen në këtë pjesë të punimit, televizionit del si medium i rëndësishëm i informimit të respondentëve dhe në të njëjtën kohë më i besueshmi nga të gjitha llojet e medimeve. Mirëpo, gjetjet sugjerojnë që në rastin e mediave të reja-portaleve, situata është ndryshe, 62 për qind e respondentëve zgjedhin portalet së paku një herë në ditë për t'u informuar, ndërsa vetëm 8 për qind e tyre nuk i përdorin portalet për informim, mirëpo besueshmëria ndaj informacioneve që qytetarët gjejnë në këto media duket se çalon. Tutje, në këtë kapitull ofrohen të dhëna që tregojnë për përdorim të lartë të rrjeteve sociale që krahasuar me studime të ngjashme në vendet e Bashkimit Evropian, përdorimi i tyre në rastin e respondentëve të këtij hulumtimi në Kosovë është gjashtë herë më i lartë. Tutje në këtë pjesë të punimit ofrohen gjetjet e anketimit sa i përket përvojës që kanë pasur respondentët me lajmet e rreme. Sipas rezultateve të anketimit, shumica e respondentëve kanë hasur më shpesh në lajme të rreme në rastin e rrjeteve sociale dhe portaleve sesa në mediat tradicionale, gazeta, radio dhe televizione. Po ashtu, në këtë pjesë të punimit përmes komperacionit të të dhënave ofrohen gjetje që tregojnë që besueshmëria në lloje të ndryshme të medias varet edhe nga përvoja e tyre me lajmet e rreme. Sipas gjetjeve, sa më shpesh që audienca ka hasur në lajme të rreme në një lloj mediumi, aq më pak i beson atij lloji. Në fund të këtij kapitulli, ofrohen gjetje në raport me mënyrën se si është e fragmentuar audienca në rastin e Kosovës. Sipas hulumtimit të realizuar përmes anketimit e i cili prezantohet në këtë pjesë të punimit, fragmentimi ka dy qasje kryesore në rastin e Kosovës, atë me median në qendër dhe atë me përdoruesin në qendër. Tutje në kapitullin tjetër ofrohen gjetje në fushën e tretë të këtij studimi atë të trajtimit të aspektit ligjor, rregullues dhe vetërregullues. Sipas gjetjeve në këtë kapitull ligjet në Kosovë janë miratuar para se radiot dhe televizionet të përdorin platformat e rrjeteve sociale për të transmetuar drejtpërdrejtë gjë që ka ndikuar që këto ligje të mos jenë kompatible me ndryshimet e reja teknologjike në media.

Në kapitullin e fundit të këtij punimi, ofrohen rezultatet e testimit të hipotezës kryesore të punimi si dhe tri hipotezave të tjera ndihmëse. Sipas përfundimeve të trajtuara në këtë pjesë, pas testimit hipoteza kryesore është vërtetuar pjesërisht, ndërsa tri hipotezat ndihmëse janë vërtetuar plotësisht. Tutje, punimi përmban në format standarde të citimit edhe literaturën e përdorur për këtë punim që përmban 83 libra dhe artikuj shkencorë të cituar në pjesë të ndryshme të punimit, si dhe 119 njësi tjera bibliografike ku hyjnë ligjet, dokumentet, mediat dhe databaza online. Në

shtojcën e punimit gjenden dy intervista të realizuara ekskluzivisht për këtë punim doktrate dhe pyetësoni i përdorur në anketimin e respondentëve.



## **RESUME**

This work is done within the framework of studies in the program “Communication Sciences and Journalism” in the Department of Journalism of the Faculty of Philology at the University of Prishtina “Hasan Prishtina”. This study entitled “The report between New and Traditional Media in Kosovo (newspaper, radio, and television in front of portals and social networks)”, addresses the current state of Kosovar media and the changes brought by the use of technology. The results of research through scientific methods provide the finding for three areas in the Kosovo media. The first area of research in this study is provided findings on the change that has occurred in the content of the news, the observance of professional standards of reporting in journalism. Further, this paper provides results regarding the change that has occurred with the audience in Kosovo, addressing the research results through a survey of respondents concerning the use, reliability, and experience with fake news in different types of media. In the third area, this study provides findings on the legal and self-regulatory aspects of the media in the case of Kosovo. The findings of this study are unique and new in the field of communication and media studies in Kosovo, thus providing a study that can serve the research community, the community of journalists and media, and society at large.

The thesis uses previously tested scientific methods in the study of this field. Media and communication studies have an interdisciplinary approach, therefore the methods used to derive the results in this research are of several types. The first part of the research of news-texts published in different types of media is researched through the analysis of media contents, providing a new result in this field of study. The results found through content analysis in different types of media have been treated with comparative analysis seeing the difference in reporting forms and the observance of professional reporting standards in journalism. The corpus of these contents was selected through the systematic sample of the artificial week. Further, in this study, the method of surveying respondents was used to extract results in the field of audience study. Findings were obtained through a multi-stage systematic sample survey with a representative number of respondents. The results of this research through the comparative method are treated in terms of the changes that the audience has concerning different types of media: newspapers, radio, television and new media, portals, and social networks. In the last part of the case study, the method of desk research analysis was used to derive results in the research of the legal and self-regulatory

aspects of the media in Kosovo. As part of this study, interviews were conducted which were used as a scientific method for extracting results in terms of the development of new media in Kosovo. These methods were used to test the hypotheses in this study which are four in total. The main hypothesis addresses the professional standards of reporting in journalism, the other two address the audience's relationship with the media, and the third auxiliary hypothesis addresses the aspects of legal regulation and media self-regulation in Kosovo.

The first chapter of this study deals with the theoretical framework of the study, offering the main theories in terms of the development of thought for the media. This part of the study deals with theories of communication and media starting from propaganda studies, Frankfurt Critical School, neo-Marxist studies, Toronto School, media semiotics studies, cultural studies, sociology of the profession - functionalist studies, mediamorphosis theory, theories for the press, theories for radio, theories for television, theories for new media (internet and portals) and theories for social networks. These theories are treated in terms of their contradictions and common points in the treatment of the media for the function of communication, media, and their role in society.

The following part of this study deals with the historical context in which communication and media were developed in Kosovo. From various historical sources are treated data from the first form of written communication in the Albanian language, as well as theoretical approaches to the reason for the delay in writing in this language. The two main theories discussed in this section talk about the lack of writing in the Albanian language, first in terms of the geographical spread of the population that has spoken this language and in the second level, that of the lack of public institutions as a reason for the lack of writing in this languages. In this part of the study, data are provided in different historical periods that have influenced communication and media in the Albanian language, starting from the first newspapers in the Albanian language, radio, television, etc. This chapter further addresses the period of media pluralism in Kosovo, which began after June 1999 when the United Nations administration began its work. In this sense, the study also addresses approaches to forms of regulation and self-regulation of the media market after pluralism. A subsection of this chapter deals with the historical development of online media in Kosovo. Through desk research analysis and interviews, data are provided for ten major portals in Kosovo which provide findings on ownership, the start date of online publications and ownership of internet space and similar activities for these ten portals; Gazeta Blic, Gazeta Express, Indeksonline, Insajderi, Klan Kosova, Koha, Lajmi, Rtklive, Telegrafi, Zëri.

The following part of the study presents the findings of the first part of the case study related to media content and changes in compliance with professional standards by different types of media in Kosovo. This chapter deals with the reporting forms of three televisions in relation to professional standards or news values by providing findings on the reporting forms of Radio Television of Kosovo, Kohavision Television, and Television 21. According to the findings in this part of the study, newspaper reporting is characterized by a high application of the standards measured in this study. The findings addressed the reporting forms and professional standards in three newspapers, Koha Ditore, Epoka e Re, and Kosova Sot. Further, the research findings on the forms of radio reporting are treated, providing a result that speaks of high standard reduction in this type of medium. This chapter also deals with the findings obtained through the analysis of the contents that have been published in the corpus portals of this study, gazetaexpress.com, telegrafi.com, and lajmi.net. The findings provide evidence that in these types of media there is a marked lack of implementation of some of the key reporting standards in journalism such as; lack of answers to the five main questions of reporting in journalism, the balance of information within the news, etc. Further in this chapter through comparison is addressed the application of these professional standards of reporting in journalism in traditional media, newspapers, radio, and television, compared to their application in the case of online media portals. Findings from this part of the study show that in traditional media there are occasional non-implementation of any of the standards, but in the case of portals we have a complete exception of some standards.

In the next chapter, the findings from the empirical research on the audience and its behavior concerning different types of media are presented. The findings of this part of the study show that the use of different types of media, the credibility of the public different types of media, and the frequency of their use is variable depending on several factors. According to the findings treated in this part of the study, newspapers risk being left without the public, as the trend of their use as media from which citizens are informed is declining. About half of the respondents said that they do not spend a single minute reading the newspapers during the day, while a large number of respondents expressed distrust of them. The findings of this section suggest that radio has remained a casual medium in which citizens do not see it as the main source of information. The findings made through the survey method indicate a large television viewership. According to the results presented in this part of the study, television emerges as an important medium of information for respondents and at the same time the most reliable of all types of media. But the findings suggest

that in the case of new media portals, the situation is different, 62 percent of respondents choose portals at least once a day to be informed while only 8 percent of them do not use information portals but the reliability of the information that citizens find in these media seems to falter. Further, this chapter provides data showing the high use of social networks that compared to similar studies in European Union countries, their use in the case of respondents of this research in Kosovo is six times higher. Further in this part of the study are presented the findings of the survey regarding the experience that the respondents had with the fake news. According to the survey results, most respondents have encountered more frequent fake news in the case of social networks and portals than in traditional media, newspapers, radio, and television. Also, this part of the study through data comparison is provided findings that show that credibility in different types of media also depends on their experience with fake news. According to the findings, the more often the audience has encountered fake news in some kind of medium, the less they trust that kind. At the end of this chapter, findings are provided concerning how the audience is fragmented in the case of Kosovo. According to the research conducted through the survey which is presented in this part of the study, fragmentation has two main approaches in the case of Kosovo, that with the media at the center and that with the user at the center. Further in the next chapter are presented findings in the third area of this study that of the treatment of the legal, regulatory, and self-regulatory aspect. According to the findings in this chapter, the laws in Kosovo were adopted before the radios and televisions used the social networking platforms to broadcast live, which has affected these laws to be incompatible with new technological changes in the media.

In the last chapter of this study, the test results of the main hypothesis of the study are presented as well as three additional auxiliary hypotheses. According to the conclusions addressed in this section, after testing the main hypothesis is partially confirmed, while the three auxiliary hypotheses are fully validated. Furthermore, the study contains in standard citation forms the literature used for this study which contains 83 books and scientific articles cited in various parts of the study, as well as 119 other bibliographic items including laws, documents, media, and online databases. In the appendix of the study, there are two interviews conducted exclusively for this doctoral thesis and the questionnaire used in the survey of respondents.